

VENDIM
Nr.917, datë 2.7.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS THUMANË TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Thumanë të qarkut të Durrësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Thumanë, të qarkut të Durrësit, miratuar me vendimin nr.650, datë 29.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Thumanë, të qarkut të Durrësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Thumanë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Thumanë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
6-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
13-20	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
21-40	Varrezat publike	Në pronësi
46,47,54,60,61,66,68,72-118,126,127,129,131,133,135,137,139,141-146,148,150-157,162-207,209,713-929	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
41	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
212,214,382-602,616-630	Infrastrukturë (sheshe, rrugë	Në pronësi

	vendore, lulishte dhe shërbime publike)	
119-120,122,158-161	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
377-379	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
43-45, 1289	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
215-218	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
219-221,225,235,254,255, 264,329,340,348,356,361, 367,373,603,604	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi